



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:294463

Datë: 29.08.2024

Numri i dokumentit: 06102390

C.nr.2061/2023

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D. M. nga M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Lutfi Tahiri, avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Lirim Zeka, avokat nga Prishtina, me objekt kontesti kompensim i shpenzimeve të udhëtimit, jashtë seancës, më datë 19.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET** në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit D. M. nga M., e ushtruar kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësit në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore nga data 21.11.2019 deri më datë 21.11.2022, respektivisht për 445 ditë pune, t'ia kompensojë shumën prej 70% të biletës ditore e cila është 2.00€, në shumë të përgjithshme prej 623.00€, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedh nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të detyrueshëm.
- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m i

Paditësi D. M. nga M., përmes përfaqësuesit të tij të autorizuar, më datë 21.12.2023, pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore – Drejtoria Komunale e Arsimit, në Mitrovicë, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit. Paditësi në padi ka pretenduar se i njëjti është në marrëdhënie pune tek e paditura, respektivisht në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (SHFMU) “Xh.J.”, në B., M.. Meqënëse e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin ndaj paditësit për kompensim në emër të shpenzimeve të udhëtimit, paditësi ka kërkuar nga gjykata që ta aprovojë kërkesëpadinë e tij si të bazuar dhe ta detyrojë të paditurën që paditësit në emër të shpenzimeve të udhëtimit për periudhën kohore nga data 21.11.2019 deri më datë 21.11.2022, respektivisht për 445 ditë pune, t’ia kompensojë shumën prej 70% të biletës ditore e cila është 2.00€, në shumë të përgjithshme prej 623.00€, me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të rrjedh nga data e ushtrimit të padisë e deri në pagesën përfundimtare. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar duke i specifikuar dhe atë: 104.00€ për përpilimin e padisë dhe 21.00€ për taksë gjyqësore dhe provizion bankar.

E paditura përmes përgjigjes në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit, me arsyetimin se konform dispozitës së nenit 87 të Ligjit të Punës të Kosovës, kërkesa e paditësit për periudhën para datës 21.12.2020 është parashkruar, andaj edhe paditësi nuk mund të kërkojë kompensimin për këtë periudhë, ndërsa sa i përket periudhës tjetër e ka kundërshtuar me arsyetimin se paditësi nuk ka bashkangjitur prova me të cilat provon se i njëjti ka krijuar shpenzime të udhëtimit. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar por nuk i ka specifikuar.

Pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të bashkangjitura nga ana e tyre, gjykata konstatoi se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese gjendja faktike, rrjedhimisht nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e një vendimi meritor pa caktuar fare seancë gjyqësore në kuptim të dispozitës së nenit 399 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 të kësaj dispozite ligjore është përcaktuar se: *“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”*.

Në rastin konkret gjykata gjeti se mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, respektivisht në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët

(SHFMU) “Xh. J.”, në B., M. Kjo u provua edhe përmes kontratës së punës së paditësit me nr.prot.115/2022 të datës 11.10.2022.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte nëse paditësit i takon kompensimi në emër të shpenzimeve të udhëtimit, respektivisht provueshmëria se atij i takon një kompensim i tillë.

Nga kontrata e punës për paditësin, nr.prot.115/2022 e datës 11.10.2022, rezulton se paditësi në fjalë ka themeluar marrëdhënie pune me të paditurën me status të përkohshëm, deri më datë 31.08.2023.

Nga vërtetimi me nr.prot.57-1/2023 i datës 30.11.2023, i lëshuar nga Shkolla Fillore e Mesme e Ulët (SHFMU) “Xh. J.”, në B., M. gjykata vërtetoi se paditësi për periudhën kohore nga data 21.11.2019 deri më datë 21.11.2022, ka gjithësej 445 ditë pune në këtë institucion arsimor.

Nga vërtetimi i datës 01.12.2023, i lëshuar nga Agjensioni Turistik “B. T.”, me NUI ..., me seli në M., gjykata vërtetoi se çmimi i biletës për një udhëtar në relacionin M.– B.dhe anasjelltas është 2.00€.

Nga çertifikata e vendbanimit me nr.serik B ..., e datës 01.12.2023, e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e Republikës së Kosovës, rezulton se paditësi vendbanimin e ka në M., Magjistratja e Adriatikut, nr.84.

Provave materiale të lartcekura, gjykata u’ a fali besimin e plotë në kuptim të dispozitës së nenit 329 par.1 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të.”*, dhe par.2, i cili përcakton se: *“Të njëjtën fuqi provuese e kanë edhe shkresat tjera të cilat, me dispozita të veçanta, në pikëpamje të fuqisë provuese janë barazuar me shkresat publike.”*.

Lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata vlerëson se në rastin konkret duhet të aplikohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e miratuar dhe e nënshkruar nga Qeveria e Republikës së Kosovës (Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë) dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës (SBASHK), me datë 18.04.2017 dhe ajo më datë 22.01.2021.

Çështja e kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për ditët e pranisë në punë, parashihet me dispozitën e nenit 35 par.5 të Kontratës së lartcekur, ku është përcaktuar se: *“Punonjësve arsimorë që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë, u paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*.

Gjykata gjen se nga provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk del themelësia e kërkesëpadisë së paditësit, respektivisht faktet e treguara në padi janë në kundërshtim me provat të cilat i ka bashkangjitur paditësi, pasi që i njëjti nuk ka arritur t’i bëjë të besueshme gjykatës se ka krijuar shpenzime të udhëtimit me rastin e vajtje – ardhjes në institucionin arsimor me të cilin paditësi ka të themeluar marrëdhënien e punës. Kështu paditësi me asnjë provë nuk i ka provuar gjykatës se për të shkuar në vendin e tij të punës i është dashur të udhëtojë dhe me këtë rast ka krijuar shpenzime të udhëtimit. Nga shkresat e lëndës, gjykata vërtetoi marrëdhënien e punës së paditësit me të paditurën e cila nuk ishte kontestuese as në mes të palëve ndërgjyqëse, poashtu vërtetoi edhe numrin e saktë të ditëve prezente në punë të paditësit për periudhën e kërkuar të kompensimit si dhe vërtetoi adresën e banimit të paditësit por nuk arriti të vërtetojë se paditësi ka krijuar shpenzime të udhëtimit me rastin e kryerjes së punës te e paditura, pasi që nga vërtetimi i lëshuar nga agjencioni turistik me të cilin pretendon se ka udhëtuar paditësi, e të cilin i njëjti i’ka bashkangjitur padisë vërtetohet vetëm çmimi i biletës për udhëtarë, në relacionin Mitrovicë – Bare dhe anasjelltas dhe nuk vërtetohet fakti se paditësi ka udhëtuar me këtë agjencion pasi vërtetimi në fjalë nuk përmban as emrin e udhëtarit e as periudhën e udhëtimit të udhëtarit me këtë agjencion në relacionin M. – B. dhe anasjelltas, andaj meqënëse nuk u provua fakti se paditësi ka krijuar shpenzime të udhëtimit, për të cilat do t’i takonte kompensimi i kërkuar, gjykata vendosi të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke vendosur si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 450 lidhur me nenin 463 par.1 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitës së nenit 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil

C.nr.2061/2023 më datë 19.08.2024

Gj y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.